



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ae.nr.264/2019

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Kompania e Sigurimeve [“A...”], me seli në Zurich, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [“I...”], [B.N], avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve [“K...”], me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [V.R] nga Prishtina, për shkak të regresit, në shumën e përgjithshme prej 4,465.97€, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit dhe të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, V.EK.nr.428/2017, të datës 30.05.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.09.2020 mori këtë:

### AKTGJYKIM

**REFUZOHEN** si të pabazuara ankesat e paditësit Kompania e Sigurimeve [“A...”], me seli në Zurich, dhe të paditurës Kompania e Sigurimeve [“K...”], me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, V.EK.nr.428/2017, të datës 30.05.2019, **VËRTETOHET**.

### A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, e ka miratuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Kompania e Sigurimeve [“A...”], me seli në Zurich, e paraqitur kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve [“K...”], me seli në Prishtinë, ashtu që detyrohet i padituri Kompania e Sigurimeve [“K...”], me seli në Prishtinë, që në emër të regresit paditësit t’ia kompensojë shumën në lartësi prej 4,465.97€, të gjitha me kamate ndëshkuese prej 85 në vit, duke filluar nga data 17.10.2018 e deri në pagesën definitive, të gjitha në afatin parativ prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim. Ndërsa në pikën II të dispozitivit të aktgjyqimit është detyruar e paditura që paditëses në emër të shpenzimeve procedurale t’ia paguaj shumën në lartësi prej 2,489.28€.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura Kompania e Sigurimeve ["K..."], me seli në Prishtinë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoje ankesën e të paditurës si të bazuar, të prishet aktgjykimi V.EK.nr.428/17 të datës 30.05.2019 dhe lënda i kthehet në rivendosje dhe rigjykim gjykatës së shkallës së parë, dhe të hudhet poshtë padia si e pathemelte.

Kundër këtij aktgjykim në afatin ligjore ka paraqitur ankese pala paditëse Kompania e Sigurimeve ["A..."], me seli në Zurich, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit ta miratojë ankesën e paditësit si të bazuar, dhe të ndryshoje aktgjykimin V.EK.nr.428/2017 të datës 30.05.2019 në pjesën e cila i referohet borxhit dytësore kamatëvonesës dhe shpenzimeve të kontestit, ashtu që detyrohet e paditura që paditëses në emër të rimbursimit mbi bazën e subrogimit, nga rasti i siguruar i datës 26.12.2014 t'ia paguaj shumën prej 4,465.97€ me kamatëvonesën prej 12% ne vit duke filluar nga data 25.08.2015 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e kontestit në shumën prej 2,935.28€.

#### **Ankesat janë të pabazuara.**

Kompania e Sigurimeve ["A..."], me seli në Zurich, me datën 18.09.2017 ka paraqitur padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ["K..."], me seli në Prishtinë, për kompensimin e borxhit regresit nga sigurimi kasko. I ka propozuar gjykatës që me aktgjykim të detyrohet i padituri që nga rasti i siguruar i auto përgjegjësisë i datës 26.12.2014 t'ia rimburojë kasko regresin paditëses duke i paguar shumën prej 4,779.77€, me kamatë ndëshkuese prej 12% duke filluar nga data 25.08.2015 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet kontestimore, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë. Paditësi pas nxjerrjes së ekspertizës së makinerisë të punuar nga z. [S.B] të datës 17.10.2018 ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në shumën e përgjithshme prej 4,465.97€.

Gjykata e shkallës së parë nga policia e sigurimit kasko ... dhe nga provat e administruara ka gjetur se është jo kontestuese se paditësja në cilësi të siguruesit ka hyrë në raport kontraktual me [I.K], ku lëndë e kontratës ka qenë sigurimi kasko i automjetit "Audi A6" me [numër të targave ...] pronë e të siguruarit dhe atë për periudhën e sigurimit nga data 27.01.2014- 30.06.2014. Poashtu nga raporti i Policisë së Kosovës me numër ... rezulton jo kontestuese se në Prizren ka ndodhur aksident i komunikacionit ku të përfshira në aksidentin në fjalë janë automjeti "Audi A6" i pajisur me police sigurimi kasko nga paditësja dhe automjeti i tipit "VW 1 HXO", i pajisur me policë sigurimi nga auto përgjegjësia nga e paditura. Deri të aksidenti ka ardhur me fajin ekskluziv të drejtuesit të automjetit "VW 1HXO" i cili nuk e ka përshtatur shpejtësinë e automjetit me kushtet e rrugës, ashtu që kalon në shiritin e kundërt të qarkullimit dhe e godet veturën e të siguruarit të paditësit. Poashtu është

provuar edhe me policen e sigurimit se automjeti "VW" IHXO" në momentin e aksidentit ka qenë i siguruar pranë të paditurës me sigurim të detyrueshëm nga auto përgjegjësia. Nga fatura e riparimit të automjetit të aksidentuar me numër ... të datës 28.01.2018 gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se çmimi për riparimin e automjetit të aksidentuar është në shumën prej 5,497.25€. Nga vërtetimi për pagesën e dëmit kasko me numër ... të datës 28.01.2015 është vërtetuar së paditësja ka paguar çmimin për riparimin e automjetit të aksidentuar në shumën prej 5,497.25€. Nga kushtet e përgjithshme të polices së sigurimeve, saktësisht pika A1 vlefshmëria gjeografike është vërtetuar se polica në fjalën ka mbulose siguroese edhe në Republikën e Kosovës.. Për te vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë e sil ka qenë kontestuese në mes palëve në procedure gjykata ka caktuar ekspertizën e makinerisë të punuar nga eksperti z.[S.B] ku nga mendimi dhe konstatimi i tij ka rezultuar se lartësia e dëmit të shkaktuar në automjetin "Audi A6" në kohën e aksidentit sipas çmimeve të vendit të regjistrimit Zvicrës është në shumën prej 4,465.97€, pasi qe eksperti ka konstatuar së dëmi i shkaktuar është dëm i pjesërishëm për riparimin e automjetit.

Prandaj, gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke u bazuar në dispozitat e nenin 281, 960 par.1 të LMD-së, si dhe në nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së.

Bazuar në dispozitat ligjore, gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, duke vlerësuar se me pagimin e kompensimit të dëmit nga paditësja, të gjitha të drejtat e të siguruarit kanë kaluar të paditësja dhe e paditura ka pasur obligim t'ia rimbursojë paditëses shumën e paguar në emër të kompensimit të dëmit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet te palës së paditure, lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale me arsyetimin se e drejta e subrgomit sipas nenit 960 të LMD-së nënkupton të drejtën e shoqërive të sigurimit brenda territorit të Republikës së Kosovës ndaj njëra tjetrës, ose mes shteteve që ka marrëveshje shumëpalëshe, dypalëshe ose memorandum mirëkuptimi, si dhe me arsyetimin së Kosova nuk është pjese e Këshillit të Byrove. Mirëpo kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara këto pretendime për arsye së *"sipas nenit 960 të LMD-së nënkuptohen të drejtat e shoqërive të sigurimit brenda territorit te Republikës së Kosovës ndaj njëra tjetrës ose mes shteteve qe Republika e Kosovës ka marrëveshje shumëpalëshe ose memorandum mirëkuptimi"*.

Në rastin konkret kërkohet subrogimi, andaj zbatohet dispozitat e Nenit 281 të LMD-së, i cili përcakton se: *“Kur detyrimin e përmbush personi që ka ndonjë interes juridik në këtë, atëherë i kalohet këtij, në bazë të vetë të drejtës në momentin e përmbushjes kërkesa e kreditorit me të gjitha të drejtat aksesore”*, ndërsa si dispozitë referuese për përcaktimin e natyrës juridike të subrogimit, zbatohet dispozita e Nenit 960 të LMD-së, me të cilën është përcaktuar se *“me pagimin e kompensimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin, në bazë të vetë ligjit, deri në shumën e kompensimit të paguar, të gjitha të drejtat e të siguruarit ndaj personit i cili mbi cilën bazë qoftë është përgjegjës për dëmi”*.

Bazuar në të lartëcekurat rrjedh së paditësi si sigurues i automjetit të aksidentuar mbi bazën e sigurimit auto kasko ka qene i detyruar ta kompensojë dëmin e shkaktuar mbi automjetin e siguruar, të cilën edhe e ka bërë dhe gëzon të drejtën që të regresojë shumën e paguar nga i padituri si sigurues i automjetit “VW” IHXO”, mbi bazën e sigurimit nga auto përgjegjësia për demet e shkaktuara personave të trete.

Gjykata e Apelit i shqyrtoj pretendimet ankimore të paditurës në lidhje me vlerësimin e demit në automjet respektivisht pretendimi se vlerësimi i dëmit duhet të bëhet sipas çmimeve të Kosovës, mirëpo gjeti se të njëjta janë të pabazuara për arsye se sipas nenit 8 paragrafi 2 pika g të *“Rregullores mbi procedurat e trajtimit të kërkesave për kompensimin e dëmit që rrjedh nga sigurimi i detyrueshëm nga auto përgjegjësia”* (e datës 27.10.2012 e BQK-së), thuhet se *“dëmi në mjetet motorrik të dëmtuar me targa të huaja mund të pranohet në bazë të faturës së riparimit të bërë në vendin e regjistrimit të mjetit motorrik duke bërë krahasimin e atij riparimi me procesverbalin mbi dëmin*. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vlerë reale të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga i siguruari i të paditurës, lartësia e të cilit është vërtetuar me ekspertizën e ekspertit [S.B], me të cilën janë konstatime të mbështetura në prova që gjenden në shkresat e lëndës, nga çka rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë ka pranuar çmimet e llogaritura sipas vlerave të tregut, të cilat në tërësi i pranon edhe kjo gjykatë.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore ankimore të së paditurës por gjeti se të njëjta janë të pabazuara dhe në kundërshtim me vet qëndrimin e të paditurës në procedurën e zhvilluar pranë gjykatës së shkallës së parë. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, është plotësisht i pabazuar pretendimi ankimor për vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike sepse nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë ka administruar të gjitha provat në dispozicion dhe ka shfrytëzuar të gjitha mjetet provuese për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe me të drejtë caktimin e lartësisë së kompensimit e ka bazuar në ekspertizën e makinerisë të punuar nga z. [S.B], ndërsa këto konstatime përputhen me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata e Apelit e vlerësoi si të pabazuar edhe pretendimin ankimor të paditësit lidhur me normën e kamtëvonesës së aprovuar nga gjykata e shkallës së parë, nga shkaku se kamata e kërkuar nga paditësi sipas normës prej 12 % , ligjërisht nuk aplikohet në kontestet për regresim të borxhit por vetëm në kërkesat e trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për shpërblim të dëmit në procedurën jashtëgjyqësore ashtu siç parashihet në nenin 26 të Ligjit për sigurimin e

detyrueshëm nga auto përgjegjësia. Kamata sipas normës prej 12 % është paraparë me qëllim të disiplinimit të kompanive siguruese në raportet e sigurimit ndaj kërkesave për dëmshpërblim të personave të dëmtuar të cilat kërkesa kompanitë e sigurimeve janë të detyruara që t'i trajtojnë me urgjencë brenda afateve të parapara sipas dispozitave të lartpërmendura.

Paragrafi 7, i nenit 26 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia, përjashton zbatimin e kamatës prej 12% për regresim borxhi, kamatë kjo e paraparë vetëm për mostrajtim dhe rënien në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për dëmshpërblim. Nga kjo rezulton se paditësi ka të drejtë vetëm në kamatëvonesë të paraparë me nenin 382 të LMD-së, por jo edhe kamatë 'të kualifikuar' sipas nenit 26 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia. Meqenëse, lartësia e kompensimit është përcaktuar nga ekspertiza e ekspertit të makinerisë z. [S.B], me datë 17.10.2018, rezulton se e paditura nga kjo datë ka rënë në vonesë andaj gjykata e shkallës së parë më të drejtë ka aprovuar kamatëvonesën nga kjo datë.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,**  
**Ae.nr.264/2019, dt. 14.09.2020**

**KRYETARI I KOLEGJIT,**  
**Mahir Tituli, d.v.**

